

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi në Hagë, ish-luftëtari i UÇK-së akuza politikanëve të Kosovës: Turp që po përdorni për revoltë
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/politike/denimi-ne-hage-ish-luftetari-i-uk-se-akuza-politik-aneve-te-ko-i1185235
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 20:19:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 20:07:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	010c9504e002011eb9ee97bd149b94395bf4751ef6c888f507a47bc398c08757
TEKSTI	d169bfbf88e9a8d9e1aa2f7fe08265e9c428745fcb00f4018efe837322b3144b
PAMJA	af3cd0e1fa02bdb1c2989e35dabf72c23547510228e299fbe34e21ea1d1b850c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	730abd574a784f7261f5cef2c3d0eb2a59f74af3fa3bdd34c97274ad323069c0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f72115bb0c326093347f412235a8c378aab409f85fb276171d0e9653b9a6bcb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/730abd574a784f7261f5cef2c3d0eb2a59f74af3fa3bdd34c97274ad323069c0


PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dënimi në Hagë, ish-luftëtari i UÇK-së akuza politikanëve të Kosovës: Turp që po përdomi për revoltë

Nga A2 CNN
16 Shtator 2026, 22:07 | Politikë



"Është fatkeqësi që shqiptarët në këtë dhimbje që ka Kosova për këtë vendim të padrejtë dhe që thyen dinjitetin dhe ndjenjën tonë kombëtare, të shfrytëzohet për të bërë politikë". Ish-luftëtari i UÇK-së Mečan Zotaj ka akuzuar në Off the Record me Andrea Dangllin në A2 CNN politikanët e Kosovës që po përdorin këtë moment për të nxitur revoltë.

"Nuk ja bëj avokatin e asnjërës parti politike. Faktikisht unë ndjej keqardhje për masën që manipulohet nga deputetë, nga politikanë të ndryshëm në Kosovë, sepse para vendimit ka pas politikanë që kanë bërë thirrje të armatosin shqiptarët, do djegim, do e kallim, gjë që nuk i ka kontribuar paqes në Kosovë, nuk i kontribuon shtetit të Kosovës për vazhdimësinë stabile. Sot reagimi i popullit në çdo vend ka mirëkuptimin e secilit dhe të faktorit ndërkombëtar. Sepse një popull kur dënohen liderët e luftës nuk mund të reagojë ndryshe. Do të revoltohet dhe revolta e tyre është me vend. Po thirrjet e politikanëve për revoltë nuk janë me vend dhe sulmet e opozitës në pozitë duke shfrytëzuar dhimbjen, duke shfrytëzuar fatkeqësinë kombëtare për dënimin e liderëve të UÇK-së në Hagë është shumë e ulët. Nuk tregojnë pjekuri kombëtare politike për atë që me të vërtetë Kosova ballafaqohet, por e nisnin me atë dhe përfundojnë pak edhe te interesat partiake. Kjo është ajo që ka ndodhur sistematikisht dhe për shkak të këtyre njerëzve që e kanë nisur me çështjen kombëtare dhe e kanë dashur ta rregullojnë pak nga interesat personale ka ndodhur kjo dhe jemi këtu ku jemi sot. Është fatkeqësi e madhe".

Ai u bëri thirrje qytetarëve si në Shqipëri e Kosovë që të mos të bien pre e dëshirave të politikanëve të ndryshëm apo shërbimeve të huaja për të mos rikthyer protestën e marsit 2004.

"Unë bëj thirrje të paktën secilit atij që mund ta vlerësojë fjalën time si një qytetar shqiptar i Shqipërisë dhe i Kosovës që të kenë kujdes në veprimet e tyre, mos të bien pre e dëshirave të politikanëve të ndryshëm dhe të mos bien pre e shërbimeve të huaja, mos të bëjnë një protestë si ajo e marsit të 2004-s që nisi kundër një revolte dhe një status quo-je të Kosovës dhe për vrasjen e tre fëmijëve në lumin Ibër nga serbët dhe përfundoi me djegie të objekteve fetare dhe kaloi në një konflikt që më shumë i kushtoi Kosovës tani sesa që e ndihmoi. Të kemi kujdes në reagimet tona".

Ish-luftëtari i UÇK-së apeloj që të luftojnë në Apel për identitetin kombëtar dhe pastrimin e katër figurave kryesore të UÇK-së.

"Të luftojmë të gjithë së bashku për vendimin e gjykatës të apelit, që të lirohen liderët tanë, por nga të gjithë politikanët, edhe nga ata që votuan dhe nga ata që s'votuan duhet të luftojmë për qëllimin e identitetit tonë kombëtar dhe të pastrimit definitiv edhe të katër figurave kryesore të UÇK-së e jo të bëjmë propaganda politike". (A2 Televizion)

TE FUNDIT

🔴 Nazarko: Serbia do që protestuesit të përplasen me EULEX-in

🔴 Përlotet deputetja e PDK-së: Të gjithë politikanët të bashkohen, të merren masa serioze në Parlament

🔴 Ish-komandanti i NATO-s: Bota nuk duhet ta harrojë luftën në Kosovë

Verdikti i Hagës, reagon ambasadori i Gjermanisë në Kosovë

MË TË VIZITUARAT



Kredia rritet me ritme të shpejta, Sejko: Duhet të jetë e kujdesshme dhe e sh...



Miratohet projektligji, rezerva e sigurisë së naftës do të administrohet nga ...



Ngriva, shkriva! Qeveria pendohe, bën prapakthehu dhe rikthen bordin për kar...

LIVE UPDATES



Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë



LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore



Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



“Pse Vuçiç nuk është thirrur në Hagë?”
Walker: I mërzhitur e zhgënjyer nga BE,
vendosi shenjën e barazimit me tmerret
serbe



“Sot iu bë një dhuratë Serbisë dhe
Rusisë”, Koçi për vendimin e Hagës: I fyer
çdo shqiptar



Ballkani nën kërcënimin e Serbisë?
Paralajmëron gjenerali amerikan: Ka
vende të tjera që përfitojnë



“I shokuar dhe i zemëruar”, Gjenerali i
NATO-s reagon ndaj Hagës: Thaçi nuk
është një kriminel për t'u dënuar





Pas kthimit nga SHBA, Berisha: Udhëtimi
im të shërbejë për bashkimin e
demokratëve



Vendimi për ish-krerët e UÇK-së, BE për
A2 CNN: Thirrje për vetëpërmbytje,
drejtësia të bëjë punën e saj

Latest Videos





“Ditë e zezë për Kosovën”, preket deputetja e PDK-së: Nesër në Kuvend do të merren masa serioze



“Krerët e UÇK-së do të lirohen në apel”, deputeti AAK: Nuk mund të shlyhet damka që na kanë lënë sot



“Shumë e ulët”, ish-luftëtari i UÇK-së shpërthen ndaj politikanëve të Kosovës: Turp që po përdorni



“Sot na damkosën lirinë”, deputeti i AAK-së tregon planin për të shfuqizuar Gjykatën Speciale

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulohet
Imagjinatë
Dëshmi



A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësuar nga Mediodesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.